



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2745/ 17 prot.

Datë 15.12.2025

**V E N D I M**  
**Nr. 1858/2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |        |
|------------------|--------|
| Fiorent Zguro    | Anëtar |
| Anila Malaj      | Anëtar |
| Gjergj Mersini   | Anëtar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 15.12.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1724/2025, datë 20.11.2025, dhe me Nr. 1805, datë 05.12.2025, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur –Punë –Procedurë elektronike*” me nr. Nr. **REF-62990-09-29-2025**, me objekt: “Riasfaltim rrugët Bashkia Kamëz” me fond limit 72,107,310 (shtatëdhjetë e dy milion e njëqind e shtatë mijë e treqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 06.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK me NIPT J91915001P dhe adresë, Lagjia Zall - Mner i Ri, Rruga Nacionale Kamez, 1054.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kamëz.  
Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 20.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1724/2025 ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur –Punë –Procedurë elektronike” me nr. Nr. REF-62990-09-29-2025, me objekt: “Riasfaltim rrugët Bashkia Kamëz” me fond limit 72,107,310 (shtatëdhjetë e dy milion e njëqind e shtatëdhjetë e treqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 06.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.*
2. *Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të KPP-së të shprehura në këtë vendim dhe të publikojë shtojcën respektive.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 10425 prot., datë 25.11.2025, protokolluar me tonën nr. 2745/9 prot., datë 02.12.2025, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr.1724/2025, datë 20.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik dhe ka hartuar shtojcën, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur –Punë –Procedurë elektronike” me nr. Nr. **REF-62990-09-29-2025**, me objekt: “Riasfaltim rrugët bashkia Kamëz” me fond limit 72,107,310 (shtatëdhjetë e dy milion e njëqind e shtatëdhjetë e treqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 06.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

I.3. Në datën 05.12.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1805/2025 ku vendosi:

1. *Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur –Punë –Procedurë elektronike” me nr. Nr. **REF-62990-09-29-2025**, me objekt: “Riasfaltim rrugët Bashkia Kamëz” me fond limit 72,107,310 (shtatëdhjetë e dy milion e njëqind e shtatëdhjetë e treqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 06.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.*
2. *Autoriteti kontraktor të publikojë shtojcën në zbatim të vendimit të sipërpërmendur.*
3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.4. Me shkresën nr. 10776 prot., datë 10.12.2025, protokolluar me tonën nr. 2745/14 prot., datë 12.12.2025, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr.1724/2025, datë 20.11.2025 dhe me Nr. 1805, datë 05.12.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik dhe ka hartuar shtojcën me ndryshimet përkatëse, si dhe printim nga sistemi i prokurimit elektronik, për procedurën e

prokurimit “Procedurë e Hapur –Punë –Procedurë elektronike” me nr. Nr. **REF-62990-09-29-2025**, me objekt: “Riasfaltim rrugët Bashkia Kamëz” me fond limit 72,107,310 (shtatëdhjetë e dy milion e njëqind e shtatë mijë e treqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 06.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

## II

### Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 10776 prot., datë 10.12.2025, protokolluar me tonën nr. 2745/14 prot., datë 12.12.2025, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr.1724/2025, datë 20.11.2025 dhe me Nr. 1805, datë 05.12.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik dhe ka hartuar shtojcën, me ndryshimet përkatëse, si dhe printim nga sistemi i prokurimit elektronik, duke i bashkëngjitur një screenshot si provë e publikimit të shtojcës në sistem, në zbatim të vendimit të KPP-së, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur –Punë –Procedurë elektronike” me nr. Nr. **REF-62990-09-29-2025**, me objekt: “Riasfaltim rrugët Bashkia Kamëz” me fond limit 72,107,310 (shtatëdhjetë e dy milion e njëqind e shtatë mijë e treqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 06.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka modifikuar dokumentat e tenderit, nëpërmjet një shtojce për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, e cila është në përputhje me vendimet e KPP Nr.1724/2025, datë 20.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik. Gjithashtu, nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Komisioni konstatoi se, autoriteti kontraktor e ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) në zbatim të vendimit KPP Nr.1724/2025, datë 20.11.2025, duke i bashkëngjitur një screenshot si provë e publikimit të shtojcës në sistem, në zbatim të vendimit të KPP-së.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti Bashkia Kamëz, ka zbatuar vendimet e KPP Nr.1724/2025, datë 20.11.2025 dhe Nr.1805/2025 datë 05.12.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, e ka publikuar shtojcën me ndryshimet përkatëse, sipas vendimit të sipërcituar.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur –Punë –Procedurë elektronike” me nr. Nr. **REF-62990-09-29-2025**, me objekt: “Riasfaltim rrugët bashkia Kamëz” me fond limit 72,107,310 (shtatëdhjetë e dy

milion e njëqind e shtatë mijë e treqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar me datë 06.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

